



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE
KORÇE

Nr. (481)-00463 Regj. Them
Data e Regj: 06.04.2016

Nr.1149-(443) Vendimi
Data:10.10.2016

V E N D I M

NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Korçe e perbere nga:

SOKOL IBI - Gjyqtar

Asistuar prej sekretares Viola Palla, pasi shqyrtoi ne seance gjyqesore publike, sot me date 10.10.2016, çeshtjen administrative me Nr.(481)-00463. Regj.Them, qe i perket paleve ndergjyqese:

PADITES: **Ida Tushi**, e bija e Stavri dhe e Marina, me dtl 24.02.1961, lindur ne Korce dhe banuese ne Korce (ne mungese).

I PADITUR: **Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe**, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim nga Mirela Veriga.

OBJEKTI: Shfuqizimin e aktit administrativ njoftim vleresimi per detyrimet tatimore date 12.12.2015 te Drejtorine Rajonale Tatimore Korçe.

BAZA LIGJORE: Neni 17/a i ligjit Nr.49/2012, ligji Nr.10279/2010, ligji Nr.9920/2008.

Ne perfundim te gjykimit, gjykata pasi shqyrtoi provat ne teresi, degjoi konkluzionet perfundimtare te pales se paditur e cila perfundimisht kerkoi rrezimin e padise, pala paditese ne mungese,

VEREN

Se paditesja eshte person fizik tregetar e cila e ushtron aktivitetin e saj tregetar ne qytetin e Tiranes.

Ne daten 30.06.2015 ne ambjentet ku ushtron aktivitetin e saj tregetar pala paditse ne qytetin e Tiranes ushtrojne inspektim inspektoret e Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane.

Inspektimi kryhet ne baze te urdherit e punes te dates 30.06.2015.

Inspektoret kane konstatuar se ky subjekt tregetar eshte i pajisur me kase fiskale por kasa fiskale ne momentin e kontrollit ka qene jashte funksionit.

Gjithashtu pala paditese nuk i ka paraqitur inspektoreve librin e kases fiskale.

Inspektoret kane hartuar procesverbalin e konstatimit te kundravajtjes administrative ne daten 30.06.2015 ora 10.45 dhe me pas kane hartuar procesverbalin e gjobes se dates 30.06.2015 ku kane vendosur denimin me gjobe te pales paditese ne mase ne 40.000 lekeve per kryerjen e kundravajtjes administrative te parashikuar nga neni 122/1, pika "g" i ligjit Nr.9920/2008 i ndryshuar.

Nepermjet njoftim vleresimit tatimor date 12.12.2015, pala e paditur i njofton paditese gjoben ne shumen 40.000 leke, per kryerjen e kundravajtjes administrative te mosmirembajtjes se pajisjes fiskale.

Paditesi duke mos qene dakord me kete njoftim vleresimi tatimor e kundershton ate ne Drejtorine e Apelimit Tatimor.

Drejtoria e Apelimit Tatimor me vendimin Nr.415/1 Prot, date 29.02.2016 ka vendosur te lere ne fuqi aktin administrativ njoftim vleresimi tatimor date 12.12.2015 te Drejtorise Rajonale Tatimore Korçe.

Ne te tilla rrethana pala paditese i eshte drejtuar me padine objekt gjykimi gjykates duke pretenduar se kasen fiskale ia ka vene ne dispozicion shoqerise AED Distribution pikerisht ne ate date kur u krye kontrolli 30.06.2015. Bashke me kasen fiskale kesaj shoqerie tregetare i eshte vene ne dispozicion edhe libri i mirembajtjes se kases fiskale per tu plotesuar.

Ne te tilla rrethana pala paditese pretendon se nuk e ka kryer kete kundravajtje administrative.

Pala e padiur ka prapesuar duke pretenduar se akti administrativ njoftim vleresimi per detyrimet tatimore eshte nje akt i ligjshem dhe i vlefshem.

Inspektoret e pales se paditur e kane konstatuar faktin e mospajisjes me kase fiskale ne daten 30.06.2015 ora 10.45 dhe kasa ne kete kohe ka qene ne ambjentet e pales paditese dhe nuk ka qene ne gjendje pune. Pretendimi i pales se paditur se kasa fiskale se bashku me librin e mirembajtjes kane qene ne ambjentet e shoqerise tregetare mirembajtese te kases fiskale eshte nje pretendim i pabazuar.

Ne nenin 122 te ligjit Nr.9920/2008 "Per Procedurat tatimore" parashikohet: *"Tatimpaguesi person fizik ose juridik denohet ne rast se: g) nuk mban dhe miremban ne kushte pune pajisjet fiskale ose sistemin e monitorimit te qarkullimit, me gjobe ne masen 40.000 (dyzet mije) leke".*

Gjykata vlereson se pretendimet dhe kerkimet e pales paditese ne padi jane te pabazuar ne prova dhe ne ligj.

Pretendimi i pales paditese se kasa fiskale dhe libri i kases fiskale kane qene ne momentin e kontrollit prane shoqerise mirembajtese te kases fiskale jane pretendime te pabazuaa ne prova, pasi ne momentin e ushtrimit te kontrolli kasa fiskale rezulton se ka qene ne ambjentet ku ushtronte aktivitet tregetar pala paditese dhe ka qene jo ne gjendje pune. Ky fakt eshte konstatuar ne procesverbalin e konstatimit e kundravajtjes administrative nga inspektoret e Drejtorise Rajonale Tatimroe Tirane.

Procesverbali i konstatimit dhe shkeljes dhe i gjobes eshte nje procesverbal i ligjshem dhe i vlefshem.

Ne te tilla rethana pala paditese ka kryer kundravajtjeen administrative te parashikuar nga neni 122/1, pika "g" te ligjit Nr.9920/2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise".

Per keto arsye padia e paditesit duhet rrezuar nga gjykata si e pabazuar ne prova dhe ne ligj.

Ne baze te nenit 45 te ligjit Nr. 49, date 03.05.2012 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve

Administrative”, ndaj ketij vendimi nuk lejohet ankim, sepse objekt kerkimi eshte kundershimi i akteve administrative qe permbajne detyrime ne te holla me vlere me te vogel se njezetefishi i pages minimale ne shkalle vendi. Paga minimale ne shkalle vendi me baze te V.K.M Nr.573, date 03.07.2013 eshte ne masen 22.000 leke, ndersa njezetefishi i saj eshte i barabarte me 440.000 leke.

PER KETO ARSYE

Gjykata ne baze te neneve 40, 41, 45 te ligjit Nr. 49, date 03.05.2012 “Per Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative”

VENDOSI

1. Rrezimin e padise si te pabazuar ne prova dhe ne ligj.
2. Shpenzimet gjyqesore jane ne ngarkim te pales paditese.
 - Kunder ketij vendimi nuk lejohet ankim.
 - Nje kopje e ketij vendimi ti komunikohet pales paditese ne mungese.
 - U shpall sot me date 10.10.2016 ne Korçe.

SEKRETARE

VIOLA FALLA

GJYQTAR

SOKOL IBI

Shpenzimet gjyqesore:

1. Takse pulle 3.000 leke;
Totali 3.000 leke (te parapaguara nga paditesi).